

UDHËZIM
Nr.39, datë 11.11.2008

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË VERIFIKIMIT DHE TË MARRJES NË DORËZIM TË PAJISJEVE TË MOBILIERISË PËR ARSIMIN BAZË DHE TË MESËM, NË INSTITUCIONET E VARËSISË SË MASH

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare” dhe vendimit nr.70, datë 11.3.1985 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ngritjen pranë çdo DAR/ZA të komisionit të verifikimit dhe marrjes në dorëzim të pajisjeve të mobilierisë për arsimin bazë dhe të mesëm, mbi bazën e kontratës së lidhur nga MASH me shoqërinë kontraktuese.

2. Përbërja e komisionit për çdo DAR/ZA, të jetë si më poshtë:

- a) Drejtori i DAR/ZA;
- b) Përgjegjësi i sektorit ekonomik të DAR/ZA;
- c) Inxhinieri i DAR/ZA (specialist i fushës);
- d) Drejtori i shkollës;
- e) Magazinieri i institucionit (DAR/ZA).

3. Komisioni i verifikimit dhe i marrjes në dorëzim të pajisjeve të mobilierisë për arsimin bazë dhe të mesëm, i ngritur pranë çdo DAR/ZA zbaton të gjitha procedurat për administrimin, ruajtjen dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve të mobilierisë, të përcaktuara në ligjin nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare” dhe vendimin nr.70, datë 11.3.1985 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare” të ndryshuar.

4. Akti i verifikimit dhe i marrjes në dorëzim të paraqitet nga çdo DAR/ZA brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e marrjes në dorëzim të mallit, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, (Drejtorinë e Planifikimit Buxhetor), i shoqëruar me faturat tatimore të furnizuesit dhe fletëhyrjen e institucionit përfitues (e konfirmuar dhe e vulosur nga drejtori i DAR/ZA). Akti i verifikimit dhe i marrjes në dorëzim të shoqërohet me procesverbalet përkatëse, në rast se konstatohen të meta në cilësi dhe sasi të mallit.

5. Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm mbikëqyr procesin e shpërndarjes dhe marrjes në dorëzim të pajisjeve të mobilierisë për arsimin bazë dhe të mesëm.

6. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Planifikimit Buxhetor, Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme në MASH dhe çdo DAR/ZA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja